

Specialja cakton shtatorin për deklaratat përmbyllëse për Thaçin në gjyqin për pengim të drejtësisë I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI MBETET I BLOKUAR, KURTI KËRKON MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN I FAQE 3



Deputetët e legjislaturës së 11-të të Kuvendit të Kosovës kanë dhënë betimin të enjten. Pas betimit, është ndërprerë seanca konstituive pasi Vetëvendosje nuk ka propozuar kandidat/e për kryetar/e të Kuvendit, ndërsa kryeministri në detyrë,

Albin Kurti, ka kërkuar kohë shtesë për arritjen e një marrëveshjeje politike për presidentin me partitë parlamentare. PDK-ja dhe Aleanca e kanë kritikuar vendimin për ndërprerjen e seancës konstituive, duke e

cilësuar si mungesë serioziteti dhe bllokadë institucionale, ndërsa IKD-ja, KDI-ja dhe Ambasada e ShBA-së kanë kërkuar që institucionet të formohen në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese

AKTAKUZË NDAJ 20 PERSONAVE PËR KRIME LUFTE NË GJAKOVË, AKUZOHEN PËR VRASJEN E 107 CIVILËVE F. 3



LËVIZJA REVOLTA PROTESTON PARA KUVENDIT, KËRKON SHFUQIZIMIN E LIGJIT PËR SHTETËSINË DHE TRANSPRENCË NGA MPB-ja F. 7



EKONOMITË E BALLKANIT, KOSOVA DHE SHOIPËRIA KAMPIONE NË NDËRTIM F. 8

SPORT



AGIM ADEMI TAKOHET ME LEGJENDAT E LLAPIT: FUTBOLLI NA BASHKON EDHE PËRMES BREZAVE F. 11

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VANCE: SHBA-ja DO T'I PËRDORË MJETET USHTARAKE, EKONOMIKE DHE DIPLOMATIKE PËR T'I DHËNË FUND KONFLIKTIT ME IRANIN

WASHINGTON, 6 GUSHT - Zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara, JD Vance, ka deklaruar se Uashingtoni do t'i përdorë të gjitha mjetet në dispozicion – ushtarake, ekonomike dhe diplomatike – për të arritur një zgjidhje të konfliktit me Iranin. Në një intervistë për “Fox News”, Vance ka thënë se negociatat me Teheranin janë të vështira për shkak të ndarjeve të brendshme në udhëheqjen iraniane. “Numri

një, iranianët janë njerëz jashtëzakonisht të vështirë. Numri dy, ata kanë një sistem të thyer. Ka njerëz brenda sistemit të tyre që duan që lufta të përfundojë dhe ka gjithashtu njerëz në sistemin e tyre që janë radikalë të çmendur që duan që lufta të vazhdojë. Detyra jonë është të lundrojmë përmes kësaj dhe të marrim rezultatin më të mirë për popullin amerikan dhe për presidentin e SHBA-së”, është shprehur Vance.

Ai ka thënë se pret që konflikti të zgjidhet, ndonëse sipas tij procesi do të marrë kohë. “Do të jetë e çrregullt dhe do të duhet pak kohë për të arritur atje, por do t'ia dalim. Çmimet e naftës do të ulen dhe do të qëndrojnë të ulëta”, ka deklaruar ai. Vance ka ritheksuar se Irani nuk do të lejohet të sigurojë armë bërthamore. “Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore dhe ShBA-ja do të jetë në një pozicion më të fortë. Ne do të përdorim të



gjitha mjetet që kemi ushtarake, ekonomike dhe diplomatike, për t'u siguruar që ta sjellim këtë çështje në

zgjidhjen e duhur”, ka deklaruar ai. Komentet e tij vijnë në kohën e tensioneve rreth Ngushticës së Hormuzit, pas përballjeve të fundit ushtarake ndërmjet ShBA-së dhe Iranit. Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se preferon arritjen e një marrëveshjeje me Iranin përmes diplomacisë, por ka paralajmëruar se përdorimi i forcës mbetet një opsion nëse bisedimet dështojnë.

DRONËT ME FIBRA OPTIKE PO NDRYSHOJNË LUFTËN NË UKRAINË, SFIDË E RE PËR MBROJTJEN ELEKTRONIKE



KIEV, 6 GUSHT - Lufta në Ukrainë po hyn në një fazë të re të përdorimit të teknologjisë ushtarake, me dronët me fibra optike që po shfaqen si një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e betejës. Ndryshe nga dronët tradicionalë, këto mjete ajrore lidhen me operatorin përmes një kabloje me fibra optike, e

cila bartet nga vetë droni në një bobinë. Përmes kësaj lidhjeje realizohet komunikimi dhe transmetimi i pamjeve, duke i bërë ato pothuajse të paprekshme nga sistemet e luftës elektronike që bllokojnë sinjalet radio. Sipas një analize të “BBC”-së, kjo teknologji ka dobësuar një nga mënyrat kryesore të mbrojtjes që palët

ndërluftuese kanë përdorur deri më tani, pasi sistemet elektronike nuk mund të ndërpresin lidhjen fizike mes operatorit dhe dronit. Megjithatë, dronët me fibra optike kanë edhe kufizime. Ata janë më të ngadalshëm se dronët e zakonshëm, ndërsa kabloja mund të pengohet ose të ngatërrohet gjatë fluturimit. Pavarësisht

këtyre mangësive, përdorimi i tyre, veçanërisht nga forcat ruse, ka ndikuar në ndryshimin e taktikave në vijën e frontit. Ekspertët vlerësojnë se këta dronë e kanë bërë më të rrezikshme lëvizjen e trupave, pasi janë më të vështirë për t'u neutralizuar dhe mund të godasin objektivat me saktësi të lartë.

EUROSTAT: NJË NË GJASHTË PERSONA NË BE KONSUMON DUHAN

LUKSEMBURG, 6 GUSHT - Në vitin 2025, 16.5 për qind e personave mbi moshën 16-vjeçare në Bashkimin Evropian (BE) përdornin çdo ditë duhan ose produkte të lidhura me nikotinën, si cigaret elektronike, qeskat me nikotinë apo produktet e duhanit të ngrohur. Sipas të dhënave të Eurostatit, kjo paraqet një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022, kur përqindja e përdoruesve të përditshëm ishte 17.5 për qind. Ndërkohë, 77.5 për qind e

qytetarëve të BE-së kanë deklaruar se nuk përdorin këto produkte ose nuk i kanë përdorur gjatë 12 muajve para mbledhjes së të dhënave. Përdorimi i përditshëm i duhanit dhe produkteve të ngjashme vazhdon të jetë më i lartë te burrat. Sipas Eurostatit, 20.8 për qind e burrave konsumojnë çdo ditë këto produkte, krahasuar me 12.6 për qind të grave. Edhe këto shifra kanë shënuar rënie nga viti 2022, kur përqindja ishte 22.2 për qind te burrat



dhe 13.1 për qind te gratë. Sa i përket grupmoshave, përdorimi më i lartë është regjistruar te personat 35-49 vjeç, me 21.3 për qind. Pas tyre renditen grupmosha 25-34 vjeç me 19.9 për qind dhe ajo 50-64 vjeç me 19.8 për

qind. Përqindjet më të ulëta janë regjistruar te të rinjtë 16-24 vjeç, me 12.1 për qind, si dhe te personat mbi 65 vjeç, me 9.1 për qind. Në nivel vendesh, Bullgaria ka përqindjen më të lartë të përdoruesve të përditshëm të duhanit dhe produkteve me nikotinë, me 26.3 për qind. Pas saj renditen Suedia me 23.9 për qind dhe Kroacia me 23.6 për qind. Në anën tjetër, Holanda ka regjistruar nivelin më të ulët të përdorimit të përditshëm, me 9.9 për qind,

e ndjekur nga Irlanda me 11.7 për qind, Belgjika me 13.6 për qind dhe Luksemburgu me 13.8 për qind. Nga viti 2022 deri në vitin 2025, në 17 shtete anëtare të BE-së është shënuar ulje e përdorimit të përditshëm të duhanit dhe produkteve të ngjashme. Rëniet më të mëdha janë regjistruar në Spanjë dhe Luksemburg, me nga 2.1 pikë përqindjeje. Ndërkohë, rritjet më të mëdha janë shënuar në Kroaci dhe Lituanë, me nga 2.7 pikë përqindjeje.

Italia vendos 27 qytetet kryesore në nivelin më të lartë të alarmit për të nxehtin

ROMË, 6 GUSHT - Italia do t'i vendosë të gjitha 27 qytetet e saj kryesore, nga Trieste në veri deri në Palermo në jug, në nivelin më të lartë të alarmit për të nxehtin, ndërsa vala e katërt e të nxehtit këtë verë po intensifikohet.

Alarmi i kuq nënkupton rrezik të shtuar për shëndetin e të gjithë popullsisë për shkak të temperaturave ekstreme dhe të

zgjatura, duke rritur mundësinë e situatave emergjente.

Ministria italiane e Shëndetësisë ka njoftuar se 25 qytete ishin nën alarm të kuq të mërkurën, ndërsa dy të tjera i janë shtuar listës të enjten. Kjo është hera e parë këtë vit që të gjitha 27 qytetet e monitoruara nga sistemi i mbikëqyrjes së valëve të të nxehtit vendosen

në nivelin maksimal të alarmit. Temperaturat në disa zona të Italisë janë afuar pranë 40 gradë celsius ditët e fundit. Autoritetet u kanë bërë thirrje qytetarëve të shmangin ekspozimin e drejtpërdrejtë në diell nga ora 11:00 deri në 18:00, të qëndrojnë në ambiente të mbyllura sa herë që është e mundur dhe të konsumojnë të paktën 1.5 litra

ujë në ditë.

Po ashtu, rekomandohet shmangia e pijeve të gazuara, kafesë, alkoolit dhe vakteve të rënda, veshja me rroba të lehta dhe moslënia e fëmijëve apo kafshëve brenda automjeteve. Sipas shkencëtarëve, kjo valë ekstreme e të nxehtit, e nxitur nga ndryshimet klimatike të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor, nuk pritet të zbutet



për të paktën edhe një javë. Evropa është ngrohur rreth dy herë më shpejt se mesatarja globale.

SPECIALJA CAKTON SHTATORIN PËR DEKLARATAT PËRMBYLLËSE PËR THAÇIN NË GJYQIN PËR PENGIM TË DREJTËSISË

HAGË, 6 GUSHT - Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë njoftuar se mesi i shtatorit është caktuar për mbajtjen e seancave për shpalosjen e deklaratave përmbyllëse në gjyqin kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit - të cilët akuzohen për pengim të drejtësisë.

Seancat për deklarata përmbyllëse do të mbahen më 10, 11 dhe 14 shtator, njoftoi gjykata. Ata akuzohen se, mes prillit dhe nëntorit 2023, kishin ndikuar tek dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga prokurorët për çështjen gjyqësore për krime lufte kundër vetë Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Ndaj Hashim Thaçit janë ngritur tri akuza për tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe tetë akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës.

Ndaj Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Fadil Fazliut janë ngritur, për secilin, një akuzë për tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës. Ndaj Hajredin Kuçit janë ngritur dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës. Të pesë të akuzuarit janë vetëdeklaruar të pafajshëm. Gjykimi ndaj tyre filloi më 27 shkurt, ndërsa më 13 mars, Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave. Ndërkohë, aktgjykimi ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, do të shpallet më 16 shtator. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi, akuzohen për vepra si vrasje, torturim dhe përndjekje, gjoja të kryera gjatë viteve 1998-'99 gjatë luftës për pavarësimin e Kosovës nga Serbia.

Që të katërtit i kanë mohuar këto akuza dhe janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që përfshijnë rreth 155 viktima. Prokurorët kanë kërkuar që ata të shpallen fajtorë dhe secili të dënohet me nga 45



vjet burgim për krimet e pretenduara. Mbi 130 dëshmitarë kanë dëshmuar, ndërsa janë pranuar me shkrim 160 deklarata të dëshmitarëve të tjerë në këtë gjyq gjatë tri vjetëve seanca. Gjyqi ndaj tyre ka përfunduar në shkurt, ndërsa ata janë mbajtur në paraburgim në Hagë qëkurse janë arrestuar në vitin 2020.

Gjykata Speciale është

formalisht pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Gjykimi ndaj krerëve të UÇK-së ka hasur në kundërshtime të shumta në Kosovë, pasi është parë si e njëanshme, duke qenë se në të nuk përfshihen krimet e kryera nga serbët në territorin e Kosovës. Prej atëherë, nëpër Kosovë janë vendosur

pankarte e pllakate të mëdha me mesazhin "Liria ka emër" dhe fotografi të ish-krerëve të UÇK-së. Gjithashtu ka pasur protesta kundër këtij procesi në Hagë, në Prishtinë dhe në qytete të tjera. Mijëra qytetarë kanë marrë pjesë në protestën "Drejtësi, jo politikë" në Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt këtë vit në Prishtinë, në përkrahje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

AKTAKUZË NDAJ 20 PERSONAVE PËR KRIME LUFTE NË GJAKOVË, AKUZOHEN PËR VRASJEN E 107 CIVILËVE

PRISHTINË, 6 GUSHT - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë, me propozim për mbajtjen e gjykimit në mungesë, ndaj 20 personave të akuzuar për krime lufte kundër popullsisë civile në Komunën e Gjakovës gjatë viteve 1998-1999.

Sipas njoftimit të Prokurorisë Speciale, të pandehurit M.K., R.Ç., M.D., P.R., S.K., L.O., Zh.S., S.S., L.D., Z.R., D.G., Ç.B., V.B., R.B., R.R., L.R., M.Sh., M.R., S.G. dhe T.A. akuzohen për veprën penale "Krime lufte kundër popullsisë



civile".

Në njoftim është thënë se gjatë viteve 1998-1999, M.K., në cilësinë e shefit të Sekretariatit të Punëve të Brendshme (SUP) në Gjakovë, R.Ç., në cilësinë e komandantit të njërive të

Policisë së Posaçme (PJP), dhe M.D., në cilësinë e komandantit të Brigadës së 52-të të Artilerisë Raketore, së bashku me 17 të pandehurit e tjerë si pjesëtarë të këtyre njësive, kanë marrë pjesë në një operacion të gjerë ushtarako-policor.

"Sipas aktakuzës, gjatë viteve 1998-1999, M.K., në cilësinë e shefit të Sekretariatit të Punëve të Brendshme (SUP) në Gjakovë, R.Ç., në cilësinë e komandantit të njësive të Policisë së Posaçme (PJP) dhe M.D., në cilësinë e

komandantit të Brigadës së 52-të të Artilerisë Raketore, së bashku me të pandehurit P.R., S.K., L.O., Zh.S., S.S., L.D., Z.R., D.G., Ç.B., V.B., R.B., R.R., L.R., M.Sh., M.R., S.G. dhe T.A., në cilësinë e pjesëtarëve të njësive të lartcekura, akuzohen për pjesëmarrje në vrasjen e 107 civilëve, gjatë një operacioni të gjerë ushtarako-policor", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Sipas aktakuzës, gjatë këtij operacioni ushtarako-policor civilët janë ndarë sipas gjinisë,

ndërsa ndaj tyre janë kryer vrasje, plaçkitje dhe djegie të pronave.

"Gjatë këtij operacioni, sipas aktakuzës, të pandehurit fillimisht kanë ndarë gratë dhe fëmijët nga burrat. Gratë janë plaçkitur, duke iu marrë stolitë e arit, paratë dhe sendet e tjera me vlerë, ndërsa burrat janë ekzekutuar, disa në shtëpitë dhe oborret e tyre, e disa në lokacionin e njohur si 'Ura e Taliqit'. Po ashtu, edhe shtëpitë ishin djegur", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

16 vjet nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare, Sabit Veseli

MITROVICË, 6 GUSHT - Janë bërë 16 vjet nga vdekja e veprimtarit të dalluar të çështjes kombëtare, Sabit Veseli. Veseli që në moshën 17-vjeçare ishte betuar se nuk do të ndalej së vepruari dhe luftuari deri në çlirim e vendit nga okupatori.

Vendosmëria e tij ishte dëshmuar edhe gjatë

demonstratave të vitit 1981 në Mitrovicë, ku ishte ndër organizatorët kryesorë të protestave kundër regjimit të atëhershëm. Për shkak të angazhimit të tij, ai ishte arrestuar pak ditë më vonë nga UDB-ja dhe ishte dënuar me shtatë vjet e gjysmë burgim. Pas lirimit nga burg, Veseli ka vazhduar

veprimtarinë e tij kombëtare gjatë viteve '90, duke kontribuar në organizimin e rezistencës dhe më pas në luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Sabit Veseli ka humbur jetën tragjikisht në një aksident trafiku në fshatin Kushtovë të Mitrovicës, më 6 gusht 2010.





KUVENDI MBETET I BLOKUAR, KURTI KËRKON MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN

Deputetët e legjislaturës së 11-të të Kuvendit të Kosovës kanë dhënë betimin të enjten. Pas betimit, është ndërprerë seanca konstituive pasi Vetëvendosje nuk ka propozuar kandidat/e për kryetar/e të Kuvendit, ndërsa kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka kërkuar kohë shtesë për arritjen e një marrëveshjeje politike për presidentin me partitë parlamentare. PDK-ja dhe Aleanca e kanë kritikuar vendimin për ndërprerjen e seancës konstituive, duke e cilësuar si mungesë serioziteti dhe bllokadë institucionale, ndërsa IKD-ja, KDI-ja dhe Ambasada e ShBA-së kanë kërkuar që institucionet të formohen në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kuvendi i Kosovës ka nisur seancën konstituive të legjislaturës së 11-të. Me këtë rast, deputetët e Kuvendit kanë dhënë betimin. Pas betimit, në rend të ditës ka qenë zgjedhja e kryetarit/es të Kuvendit, por kryesuesi Avni Dehari e ka shtyrë për kohë të papërcaktuar seancën konstituive, pasi kryeministri në detyrë dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka kërkuar kohë për gjetjen e një marrëveshjeje politike me LDK-në për formimin e të gjitha institucioneve të vendit. "Ne duam të ecim përpara bashkërisht, por na duhet pajtueshmëri sa më i gjerë për presidentin unifikues, ashtu siç e kërkon kushtetutshmëria, për të cilën u betuam sot. Konstituimi kësaj radhe nuk bën të jetë sërish drejt edhe një shpërndarje të Kuvendit dhe përsëri zgjedhjeve të parakohshme, të paarsyeshme,

të panevojshme për qytetarët e të dëmshme për ekonominë", ka thënë Kurti.

Në këtë kontekst, Dehari ka thënë se "meqë nuk ka propozim për kryetar të Kuvendit nga partia fituese, detyrohem ta ndërpres seancën". Ai ka bërë me dije se Kryesia e Kuvendit do të njoftojë për kohën kur do të mbahet vazhdimi i seancës konstituive.

Kurti: Për t'i shmangur zgjedhjet e reja duhet t'u japim shans bisedimeve

Pas ndërprerjes së seancës konstituive, kryeministri në detyrë dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë në një konferencë për medie se partia e tij kërkon bisedime me partitë e tjera parlamentare për ta gjetur një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit, para se të vazhdohet me seancën. "Është e nevojshme t'i kthehemi

diskutimeve për ta zgjidhur çështjen e presidentit dhe kur ta kemi një marrëveshje ta thërrasim vazhdimin e seancës konstituive", ka thënë Kurti.

Duke folur pas ndërprerjes së seancës konstituive, Kurti ka thënë se "pra, kur të kemi të siguar që kemi bërë çdo gjë për ta shmangur shkuarjen edhe në një palë zgjedhje të panevojshme për shtetin, të paarsyeshme për qytetarët e të dëmshme për buxhetin dhe ekonominë".

Kurti ka qenë në bisedime me LDK-në, por deri tani nuk ka arritur pajtueshmëri. Ai ka ftuar për bisedime edhe PDK-në dhe Aleancën, të cilat e kanë refuzuar deri tani, duke zgjedhur të qëndrojnë në opozitë. "Është e nevojshme t'i jepet shans vazhdimi të diskutimit para se të lëvizim me konstituimin e Kuvendit. Unë dua bashkëpunim, prandaj marrë iniciativë, prandaj komunikojmë, veçse unë mund të kem lajme të reja për juve atëherë kur do të kemi

marrëveshje", ka thënë Kurti, duke shtuar se takimet e tij të deritanishme me LDK-në "nuk janë më lajme".

Sipas tij, lajm do të ishte marrëveshja. LDK-ja ka kërkuar postin e presidentit, pavarësisht insistimit të Kurtit që presidenti të jetë jopartiak, por "një figurë konsensuale, e pranueshme për të gjithë". Kurti ka thënë se për të lajm do të ishte nëse PDK-ja dhe Aleanca pranojnë të hyjnë në bisedime. "Por, më duhet ta pranoj që takimet me PDK-në e AAK-në do të ishin lajm dhe unë uroj që të kemi lajme të tilla sepse ato janë të mira. Na duhet të marrim kohë shtesë për diskutime dhe vetëm atëherë kur ta kemi arritur pajtueshmëri për çështjen e presidentit të procedojmë me konstituimin e institucioneve të tjera. Herën e kaluar e pamë që pa e zgjidhur çështjen e presidentit kot e konstituojmë Kuvendin apo e votojmë e formojmë qeverinë, sepse vendi u desh të shkonte në zgjedhje", ka thënë Kurti.

Hamza për shtyrjen e seancës: Mungesë serioziteti nga Lëvizja Vetëvendosje

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka reaguar ndaj vendimit për shtyrjen e seancës për konstituimin e Kuvendit të Kosovës.

Hamza, duke folur për gazetarët

në hollin e Kuvendit, e ka quajtur papërgjegjësi këtë vendim. "Kjo është një shenjë e mungesës së seriozitetit nga partia që ka fituar shumicën e votave. Po shihet që vazhdojnë sjelljet e tyre të papërgjegjshme në raport me institucionet", ka thënë Hamza. I pyetur nëse do ta shqyrtonin një takim me LV-në, Hamza ka thënë se nuk kanë nevojë për takime "pa rezultat". "Nuk kemi nevojë të takohemi. Ne kemi deklaruar rolin tonë që do të jemi parti në opozitë", ka thënë Hamza.

Krahas deklarimit të Hamzës, PDK-ja ka lëshuar edhe një reagim publik në lidhje me moskonstituimin e Kuvendit. PDK-ja ka vlerësuar se moskonstituimi i Kuvendit është në kundërshtim me frymën dhe detyrimet e përcaktuara nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese. "Seanca e sotme dëshmoi qartë se zvarritja e krijimit të institucioneve nuk është pasojë e rrethanave apo e mungesës së votave, por rezultat i një zgjedhjeje politike të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Albin Kurtit", është thënë në reagimin e PDK-së.

Sipas kësaj partie, nuk ka pasur arsye që të mos propozohej kandidati për kryetar të Kuvendit dhe të procedohej me votimin për konstituimin e institucionit më të lartë ligjvënës. "Aq më tepër kur Gjykata Kushtetuese ka qenë e qartë në aktgjykimin e saj se Kuvendi jo vetëm duhet të

mbilidhet, por duhet të konstituohet brenda afatit 30-ditor nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve”, është thënë në reagimin e PDK-së. PDK-ja ka vlerësuar se mosveprimi i LV-së përbën shpërfillje të rendit kushtetues dhe të detyrimeve që burojnë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. “Askush nuk është mbi Kushtetutën dhe askush nuk ka të drejtë të mbajë peng institucionet e Republikës për interesa partiake”, është thënë në reagimin e PDK-së. Në fund, PDK-ja ka kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Albin Kurti që të respektojnë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të heqin dorë nga bllokada institucionale dhe të mundësojnë konstituimin e Kuvendit të Kosovës.

Zemaj: LDK-ja nuk ishte në dijeni për planet e shtyrjes së seancës

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka reaguar ndaj vendimit për shtyrjen e seancës për konstituimin e Kuvendit. Sipas tij, LDK-ja nuk ka qenë “as e njoftuar as e informuar”. “Ky është Albin Kurti. Ai di edhe të debatojë, edhe të hapë fushatë elektorale, edhe të kërkojë kohë shtesë, duke menduar se është një dhe i vetmi mbi Kushtetutën dhe vullnetin politik të dalë nga zgjedhjet e fundit”, ka thënë ai. Sa i përket mundësisë për një marrëveshje politike me LV-në, Zemaj ka thënë se shpreson se “mund të ketë lëvizje pozitive”.

Tahiri i Aleancës: Nuk kemi të bëjmë me një problem kushtetues, por me logjikë autoritare

Papërgjegjësi dhe veprim për “pazar politik” e ka konsideruar mospropozimin e kandidatit/es për kryetar/e të Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri. Sipas tij, moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës është “jashtëzakonisht i dëmshëm për Kosovën”. “Nuk kemi të bëjmë me një problem kushtetues. Këtu ka problem me një logjikë autoritare për t’ia arritur t’i marrë të tri pushtetet: presidentin, Qeverinë dhe Kuvendin. Nuk kemi të bëjmë me krizë kushtetuese. Është e pastër sikur loti procedura dhe është situata jashtëzakonisht e lexueshme”, ka thënë Tahiri. Tahiri ka kritikuar kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për mosarritjen e një marrëveshjeje. “Nëse ka qenë qëllimi për me dalë prej këtij rrethi vicioz dyvjeçar, pse nuk ke fol me partitë politike për presidentin e Kosovës, se njyja, problemi thelbësor nuk është te qeveria, nuk është te Kuvendi, por është te presidenti, po e ke neglizhuar deri në këtë ditë”, ka thënë Tahiri.



IKD-ja: Ndërprerja e seancës cenon Kushtetutën, nuk arsyetohet me mungesën e marrëveshjes

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka thënë se është thellësisht i shqetësuar për ndërprerjen e seancës konstituive në prag të përfundimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit. Ky institut, përmes një deklarate për media, ka theksuar se mungesa e një marrëveshjeje politike nuk mund të shndërrohet në arsye “për bllokimin e Kuvendit dhe

cenimin e rendit kushtetues”. Sipas IKD-së, kërkesa e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, për kohë shtesë për bisedime me partitë parlamentare dhe vendimi i kryesuesit Avni Dehari për ndërprerjen e seancës, nuk mund të mbështeten në natyrën dhe qëllimin e seancës konstituive. “Sipas nenit 9, paragrafit 3, të Rregullores së Kuvendit, në seancën konstituive nuk zhvillohet debat. Rrjedhimisht, kjo seancë nuk mund të përdoret për diskutime politike, kërkesa jashtë rendit të përcaktuar apo kushtëzimin e konstituimit me marrëveshje për çështje të tjera”, është thënë në deklaratën e IKD-së.

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar qartë detyrimin e deputetëve që Kuvendi të konstituohet brenda afatit prej tridhjetë ditësh, ka vlerësuar IKD-ja. “Ky nuk është afat orientues dhe as çështje e vullnetit politik, por detyrim kushtetues që duhet respektuar nga secili deputet dhe nga organet që drejtojnë seancën. Fakti se Kushtetuta dhe aktgjykimet e Gjykatës nuk kanë përcaktuar shprehimisht pasojën juridike për moskonstituimin brenda afatit nuk krijon leje për shkeljen e tij”, ka theksuar IKD-ja. Sipas IKD-së, edhe pse Kushtetuta nuk përcakton shprehimisht ndëshkim për mospërmbushjen e afatit të saj, kjo nuk e bën të ligjshme shkeljen e Kushtetutës. “Kushtetuta nuk zbatohet vetëm kur parashikon ndëshkim, ajo duhet të respektohet sepse është akti më i lartë juridik i Republikës”.

KDI-ja i bën thirrje LV-së që “pa vonesë” ta propozojë kandidatin për kryeparlamentar

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i ka bërë thirrje Lëvizjes Vetëvendosje që, si subjekt fitues i zgjedhjeve, pa vonesë ta ushtrojë të drejtën dhe përgjegjësinë kushtetuese për të propozuar kandidaturën për kryetar të Kuvendit. Përmes një reagimi, KDI-ja ka shprehur keqardhje që sot nuk është konstituuar organi ligjvënës, pasi LV-ja nuk e ka propozuar kandidatin për kryetar, me arsyetimin se i nevojitet kohë shtesë për arritjen e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit. KDI-ja ka thënë se mirëpret çdo përpjekje serioze për arritjen e një marrëveshjeje politike mes partive, por ka theksuar se “dialogu politik dhe respektimi i afateve kushtetuese nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, por duhet të zhvillohen paralelisht”. Takimet dypalëshe, konsultimet me të gjera dhe format e tjera të komunikimit politik, sipas KDI-së, mund dhe duhet të vazhdojnë, veçanërisht për çështjen e zgjedhjes së presidentit. “Megjithatë, është e domosdoshme që fillimisht të përfundojë konstituimi i Kuvendit, në mënyrë që të nisin procedurat e tjera kushtetuese, përfshirë afatin 60-ditor për zgjedhjen e presidentit”, është thënë në reagimin e KDI-së.

Ambasada e ShBA-së: Ngërçi politik po i kushton Kosovës, institucionet të formohen sipas Kushtetutës

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë u ka bërë thirrje liderëve politikë në Kosovë që të bashkëpunojnë për formimin e

institucioneve të reja, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në një përgjigje për “Express”, ambasada ka theksuar se qytetarët presin nga udhëheqësit politikë të veprojnë në interes të vendit. “Udhëheqja politike e Kosovës duhet të bashkëpunojë për të formuar institucionet në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Populli i Kosovës pret nga udhëheqësit e tij që të përmbushin zotimin për të punuar në interesin më të mirë të vendit”, është thënë nga Ambasada e ShBA-së. Ambasada ka paralajmëruar se ngërçi politik po i shkakton dëme Kosovës dhe u ka bërë thirrje liderëve që t’i japin përparësi stabilitetit dhe progresit. “Qytetarët e Kosovës presin nga udhëheqësit e tyre që ta përmbushin zotimin për të vepruar në interesin më të mirë të vendit. Ky ngërç i vazhdueshëm politik po i kushton Kosovës mundësi të humbura. Ka ardhur koha që udhëheqësit t’i japin përparësi progresit dhe stabilitetit, në të mirë të të gjithë qytetarëve”, është theksuar në përgjigjen e Ambasadës së ShBA-së. Afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit përfundon sonte në orën 23:59, ndërsa seanca konstituive u ndërpre pasi Lëvizja Vetëvendosje nuk propozoi kandidat për kryetar të Kuvendit.

OVLUÇK-ja: Kosova nuk ka kohë për të humbur, Kurti të krijojë institucionet

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK) ka reaguar ndaj bllokadës institucionale në Kosovë, duke e bërë përgjegjës kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për mosfunksionimin e Kuvendit dhe vonesën në krijimin e institucioneve të reja. Në reagim, OVLUÇK-ja ka kundërshtuar, siç është thënë, “çdo përpjekje për ta mbajtur Kosovën peng të llogarive partiake të Albin Kurtit”, duke vlerësuar se situata e krijuar po cenon funksionimin e shtetit. “Pas zgjedhjeve, Kuvendi ende nuk funksionon dot, ndërsa vendi mbetet pa qeveri me mandat të plotë. Kjo nuk është strategji. Është sulm ndaj rendit institucional dhe ndaj vetë sigurisë së shtetit”, është thënë në reagim. Veteranët kanë theksuar se përgjegjësinë kryesore për krizën politike e mban lideri i Lëvizjes Vetëvendosje. “Përgjegjësinë kryesore e mban Albin Kurti. Refuzimi i tij për ta vënë interesin kombëtar mbi pushtetin partiak e thëllon paqëndrueshmërinë dhe dëmton lidhjet me aleatët tanë strategjikë, mbi të gjitha me Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

Komuna e Mitrovicës shpërndan 200 pako ushqimore për familjet në nevojë

MITROVICË, 6 GUSHT - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka shpërndarë 200 pako ushqimore për familjet në nevojë. Sipas njoftimit të komunës, pakot janë dhuruar nga shoqata “Jetimat e Ballkanit”, e udhëhequr nga Halil Kastrati,

dhe janë dedikuar për familjet që kanë nevojë për mbështetje sociale. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe shoqatës humanitare, me qëllim të ofrimit të ndihmës për qytetarët në gjendje të vështirë

ekonomike.

Komuna e Mitrovicës ka shprehur mirënjohje për ndihmën e vazhdueshme që “Jetimat e Ballkanit” ka ofruar për qytetarët, duke theksuar se bashkëpunimi dhe mbështetja institucionale ndaj kësaj shoqate do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



NDALOHEN DY PERSONA PËR LËNDIM TË RËNDË TRUPOR, ARMËMBAJTJE PA LEJE DHE KANOSJE



PRISHTINË, 6 GUSHT - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ndaluar për 48 orë dy persona të dyshuar për veprat penale “Lëndimi i rëndë trupor”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Kanosja”. Sipas njoftimit të prokurorisë, të dyshuarit me inicialet A.D. dhe

L.D. janë paraqitur në Policinë e Kosovës, ndërsa me aktvendim të Prokurorit të Shtetit ndaj tyre u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh. Rasti lidhet me një incident të ndodhur më 23 mars 2026 në Prishtinë, ku i dëmtuar ka qenë një zyrtar i Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK).

Në njoftim është thënë se gjatë veprimeve hetimore të ndërmarra deri më tani janë siguruar dëshmi që mbështesin dyshimin e bazuar ndaj të dyshuarve. Prokuroria ka bërë me dije se hetimet intensive kanë për qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të rastit, ndërsa ato

do të vazhdojnë për sigurimin e provave dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes. “Prokurori i Shtetit është duke vazhduar ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, me qëllim të sigurimit të provave dhe zbardhjes së plotë

të kësaj ngjarjeje”, është thënë në njoftim.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka theksuar se, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do të vazhdojë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për ndjekjen penale të personave të dyshuar për shkelje të ligjit.

Drejtori i Urbanizmit në Gjilan njofton nisjen e projektit 18 milionësh për Bulevardin dhe Administratën e re Komunale

GJILAN, 6 GUSHT - Drejtori i Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, Flakron Rexhepi, ka njoftuar se ka nisur faza intensive e ndërtimit të një projekti të madh urban në qytet, i cili përfshin ndërtimin e Bulevardit dhe objektit të ri të Administratës Komunale. Përmes një postimi në “Facebook”, Rexhepi ka bërë të ditur se pas përfundimit të ndërhyrjeve të para infrastrukturore dhe

përgatitjes së brezit qendror, projekti ka hyrë zyrtarisht në fazën e ndërtimit. Sipas tij, Drejtoria e Urbanizmit ka përmbyllur koordinimet e nevojshme administrative dhe teknike për realizimin e këtij projekti. “Pas përfundimit me sukses të të gjitha ndërhyrjeve të para infrastrukturore dhe përgatitjes së plotë të brezit qendror, projekti i përbashkët i Bulevardit dhe Administratës

së re Komunale po kalon zyrtarisht në fazën e tij më intensive të ndërtimit. Drejtoria e Urbanizmit ka përmbyllur me saktësi të gjitha koordinimet e nevojshme administrative dhe teknike, duke siguruar që ky projekt integral të zhvillohet sipas planeve tona dinamike të parashikuara që nga dita e parë”, ka shkruar Rexhepi. Investimi në këtë projekt kap vlerën e rreth 18 milionë



eurove. Sipas Rexhepit, ai synon krijimin e një Gjilani modern, me hapësira të

gjelbra, parkingje nëntokësore dhe infrastrukturë të standardeve evropiane.

MINTI ME KONTROLLE NË SEKTORIN E QUMËSHTIT: PRODUKTET ME ETIKETA TË PASAKTA DO TË TËRHIQEN NGA TREGU



PRISHTINË, 6 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), njoftoi se nga 6 gushti, do të nisë kontrolle intensive, shqiptim të ndëshkimeve dhe tërheqje të produkteve nga tregu, në rast se në etiketat e produkteve të qumështit ka deklarim të pasaktë ose modeklarim të përdorimit të qumështit pluhur, vajit të palmës apo përbërësve të tjerë. Njoftimi vjen pas prezantimit të gjetjeve nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, e cila një ditë më parë ka thënë se në rreth 20 për qind të mostrave të analizuar të produkteve të qumështit në Kosovë, pati mospërputhje mes përbërësve dhe deklarimeve në etiketë. Shumica e mospërputhjeve kishin të bënin me praninë, por jo me deklarimin e vajit të palmës. Gjetjet janë publikuar pas një

kontrolli të përgjithshëm për rreth 3 muaj të kryer nga AUV-ja. Sipas njoftimit të MINTI-t, nga 6 gushti, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), së bashku me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, do të kryejnë kontrolle në të gjitha hallkat e zinxhirit të furnizimit dhe tregtimit, duke përfshirë prodhuesit, importuesit, distributorët, depot, shitësit me shumicë dhe pikat e shitjes me pakicë. MINTI ka thënë se çdo produkt për të cilin, pasi të jenë kryer verifikime zyrtare dhe analizave laboratorike, konstatohet se etiketa nuk pasqyron përmbajtjen reale, “do të tërhiqet menjëherë nga tregu, në përputhje me procedurat ligjore”. “Ndaj operatorëve ekonomikë përgjegjës do të ndërmerren masa administrative dhe ndëshkuese, duke përfshirë

gjokat, tërheqjen e produkteve nga tregu dhe çdo masë tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi”, ka paralajmëruar kjo ministri. Kontrollat intensive, sipas MINTI-t, do të përqendrohen në përputhjen mes përbërjes reale të produktit dhe deklarimit në etiketë, deklarimit të qumështit pluhur, vajit të palmës dhe çdo përbërësi tjetër, saktësinë e emërimit dhe prezantimit të produkteve, dokumentacionin e lëndëve të para si dhe produkteve që mbahen për tregtim ose ofrohen për shitje, MINTI ka thënë se mosdeklarimi apo deklarimi i pasaktë i përbërjes së produkteve përbën shkelje të legjislacionit në fuqi dhe mashtrim të konsumatorit. “Asnjë operator ekonomik nuk do të lejohet të përfitojë në kurriz të qytetarëve duke fshehur përbërjen reale të produkteve ose duke i

paraqitur ato ndryshe nga çfarë janë në të vërtetë. Mbrojtja e konsumatorit është detyrim ligjor dhe prioritet institucional”, është thënë në njoftimin e MINTI-t. Debat për çështjen e sigurisë së produkteve të qumështit u intensifikua në fillim të muajit të kaluar, pasi inspektorët e AUV-së, më 2 korrik, kanë kryer kontrolle në fabrikën “Vita” në Istog, ku kanë marrë mostra të qumështit me afat të gjatë përdorimi, qumështit pluhur dhe vajit të palmës për analiza laboratorike. Kompania më pas ka pezulluar përkohësisht punën dhe pati përplasje mes drejtuesve të kompanisë dhe ministrit në detyrë të Bujqësisë, Armend Muja. Drejtuesit e kompanisë “Vita” e kanë konsideruar këtë kontroll selektiv dhe e akuzuan ekzekutivin se po i trajton sikur të ishin “kriminelë”.

Në rezultatet që AUV-i ka prezantuar në konferencën e së martës ishin listuar edhe disa mostra të kompanisë “Abrazen”, që është kompania amë e Qumështores “Vita”.

Në listën e prezantuar, shkruan se në mostrën “qumësht”, vaji i palmës është detektuar por jo i deklaruar. Por, “Vita” ka mohuar se në qumështin e saj ka vaj palme, duke i cilësuar rezultatet e publikuara nga institucionet si të pavërteta.

Në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë” në pyetjet e dërguara në adresë të Qumështores “Vita”, kjo kompani ka mohuar kategorikisht prezencën e vajit të palmës në qumështin “Vita”, duke i quajtur rezultatet e publikuara sot si të pavërteta.

AUV-i nuk e ka bërë të qartë saktësisht listën e plotë të kompanive produktet e të cilave janë testuar, ndonëse e ka prezantuar një listë me 38 mostra ku janë gjetur mospërputhje, edhe pse në fillim të konferencës u tha se janë 93 mostra në total me mospërputhje.

Sipas legjislacionit aktual në Kosovë, nuk ka një kufi të veçantë që përcakton se në çfarë sasive mund të përdoret vaji i palmës në produktet ushqimore dhe ato të qumështit. Por, sipas një rregulloreje të Bashkimit Evropian, produkte të qumështit konsiderohen ato produkte që nxirren nga qumështi dhe që gjatë prodhimit të tyre nuk është shtuar asnjë substancë që zëvendëson një përbërës të qumështit.

Madje termat si “djathë”, “kos”, “gjalpë” rezervohen vetëm për produkte nga qumështi, e që nuk lejohet të përdoren për produkte që kanë të shtuara yndyra bimore për t'i zëvendësuar yndyrat shtazore të qumështit.

Pacolli ua shkëput kontratat e punës nëntë zyrtarëve serbë

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ministria në detyrë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, ka bërë me dije se janë shkëputur kontratat e punës për nëntë zyrtarë nga institucionet vartëse të ministrisë, për shkak të mungesës së vazhdueshme në vendin e punës. Sipas Pacollit, vendimet përfshijnë shtatë zyrtarë të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe dy zyrtarë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) nga komuniteti serbë, të

cilët, sipas saj, njihen edhe si pjesëtarë të ish-“Mbrojtjes Civile”. Ajo ka bërë me dije se vendimet janë marrë bazuar në mungesën e vazhdueshme në punë dhe në rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Me këto vendime, numri i përgjithshëm i kontratave të punës të shkëputura në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucioneve vartëse ka arritur në 29.

Pacolli, më herët janë shkëputur kontratat e punës për 20 zyrtarë të ministrisë, ndërsa tani edhe për nëntë zyrtarë të AMMK-së dhe AKK-së. “Askush nuk mund të mbajë statusin e të punësuarit pa përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës. Do të jemi të pakompromis në zbatimin e ligjit, pa dallim përkatësie apo pozite, sepse zyrtari publik duhet t’u shërbejë qytetarëve me përgjegjësi dhe respektim të plotë të detyrës zyrtare”, ka njoftuar Pacolli.



EKONOMITË E BALLKANIT, KOSOVA DHE SHQIPËRIA KAMPIONE NË NDËRTIM

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk mbështeten në të njëjtët motorë zhvillimi. Disa vende kanë ruajtur një bazë relativisht të fortë industriale, të tjera varen më shumë nga tregtia, turizmi dhe shërbimet, ndërsa Shqipëria dhe Kosova dallohen për peshën e lartë të ndërtimit, krahas rolit të rëndësishëm të industrisë dhe tregtisë në Kosovë dhe bujqësisë në Shqipëri.

“Monitor” ka përpunuar të dhënat e Eurostat dhe ka krahasuar strukturën e vlerës së shtuar bruto sipas aktivitetit ekonomik (pa përfshirë neto taksat dhe subvencionet) për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe mesataren e Bashkimit Evropian për vitin 2024, të dhënat më të fundit të disponueshme. Modelet e rritjes në rajon ndryshojnë ndjeshëm jo vetëm nga njëri-tjetri, por edhe nga ekonomia mesatare e Bashkimit Evropian. Në BE, aktiviteti ekonomik është më i shpërndarë ndërmjet industrisë, shërbimeve profesionale, administratës publike, pasurive të paluajtshme dhe financave, ndërsa vendet e Ballkanit vijojnë të kenë një përqendrim më të madh në sektorë tradicionalë. Krahasimi tregon se Shqipëria dhe Kosova kanë modele të ndryshme, por të dyja mbështeten ndjeshëm te ndërtimi dhe aktivitetet tradicionale, ndërsa vendet e tjera të rajonit kanë ruajtur një bazë më të fortë industriale ose janë orientuar më shumë drejt shërbimeve me vlerë të shtuar.

Shqipëria, ekonomia më e varur nga ndërtimi dhe bujqësia

Shqipëria është vendi ku ndërtimi zë peshën më të lartë në ekonomi. Sipas të dhënave të grafikut, sektori gjeneron 13.8 për qind të vlerës së shtuar bruto, më shumë se dyfishi i mesatares së Bashkimit Evropian prej 5.5 për qind dhe dukshëm mbi të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Peshë e ndërtimit në Shqipëri rezultojnë më e larta në Evropë. Në Kosovë ky sektor përbën rreth 10 për qind të ekonomisë, në Maqedoninë e Veriut 7.2 për qind, ndërsa në Serbi 5.9 për qind, në



Bosnjë e Hercegovinë 5.6 për qind dhe në Mal të Zi rreth 5 për qind. Zgjerimi i shpejtë i ndërtimeve, i mbështetur nga investimet në banesa, struktura turistike dhe zhvillime të mëdha në zonat urbane e bregdetare, ka qenë një ndër burimet kryesore të rritjes ekonomike të Shqipërisë gjatë viteve të fundit. Por mbështetja e lartë te ndërtimi nuk përfaqëson domosdoshmërisht një model të qëndrueshëm zhvillimi në afat të gjatë. Ndërtimi mund të krijojë punësim, të tërheqë kapital dhe të ushqejë sektorë të lidhur me të, por krijon më pak hapësirë për rritjen e produktivitetit, eksportet dhe inovacionin sesa industria përpunuese, teknologjia apo shërbimet profesionale. Pasi përfundon cikli i investimit, aftësia e tij për të prodhuar vazhdimisht vlerë të re është më e kufizuar. Për më tepër, ky sektor ka shërbyer edhe si kanal për hyrjen e parave informale në vend, duke ndikuar në rritjen e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe në uljen e përballueshmërisë së baneave për vendasit. Përveç ndërtimit, Shqipëria ka edhe peshën më të lartë të bujqësisë në rajon. Ky sektor gjeneron rreth 17-18 për qind të vlerës së shtuar bruto, kundrejt më pak se 2 për qind në BE. Diferenca tregon se një pjesë e konsiderueshme e ekonomisë dhe punësimit vazhdon të jetë e përqendruar në aktivitetet me produktivitet relativisht të ulët. Industria zë rreth 12 për qind të

ekonomisë shqiptare, një nivel dukshëm më i ulët se mesatarja e BE-së dhe se vendet e tjera të rajonit. Ndërkohë, tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore përbëjnë më shumë se një të pestën e ekonomisë, duke reflektuar rolin në rritje të turizmit dhe konsumit. Në kahun pozitiv, Shqipëria ka shënuar zhvillim relativisht të mirë në aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, së bashku me shërbimet administrative dhe mbështetëse. Peshë e këtij grupi aktiviteteve në vlerën e shtuar bruto arriti në 8.4 për qind, e dyta më e lartë në rajon pas Serbisë.

Kosova, mbështetja te industria, tregtia dhe ndërtimi

Kosova ka një strukturë ku industria, tregtia dhe ndërtimi zënë pjesën më të madhe të ekonomisë. Industria gjeneron më shumë se një të pestën e vlerës së shtuar bruto, përkatësisht 22.8 për qind, ndër nivelet më të larta në Ballkanin Perëndimor. Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor përbëjnë rreth një të katërtën e ekonomisë, duke reflektuar rolin e madh të konsumit dhe aktiviteteve tregtare. Ndërtimi ka një peshë prej afërsisht 10 për qind, e dyta më e larta në rajon pas Shqipërisë dhe ndër nivelet më të larta në Evropë. Edhe bujqësia vijon të jetë relativisht e rëndësishme, me 9.3 për qind të vlerës së

shtuar bruto. Në të kundërt, informacioni dhe komunikimi, financat dhe shërbimet profesionale mbeten më pak të zhvilluara se në ekonomitë më të avancuara të rajonit dhe mesataren evropiane. Struktura e Kosovës tregon një bazë më të fortë industriale krahasuar me Shqipërinë, por ende me varësi të lartë nga sektorët tradicionalë dhe me hapësirë të konsiderueshme për zhvillimin e shërbimeve të bazuara në njohuri.

Serbia ndërton një model më të orientuar drejt teknologjisë

Në kontrast me Shqipërinë dhe Kosovën, Serbia dallohet për zhvillimin e sektorit të informacionit dhe komunikimit. Ky aktivitet ka arritur të gjenerojë rreth 10 për qind të vlerës së shtuar bruto, peshë më e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe afërsisht dyfishi i mesatares së Bashkimit Evropian. Për Shqipërinë ky tregues është vetëm 2.6 për qind, ndërsa për Kosovën 2.5 për qind. Rritja e teknologjisë së informacionit e ka ndihmuar Serbinë të krijojë një model ekonomik më të orientuar drejt eksporteve të shërbimeve me vlerë të shtuar, punësimit të kualifikuar dhe investimeve në njohuri. Struktura e ekonomisë serbe është më e diversifikuar. Industria zë rreth një të pestën e vlerës së shtuar bruto (21.2 për qind), ndërsa ndërtimi ka një peshë më të kontrolluar, prej rreth 6 për qind.

Mali i Zi, ekonomia më e varur nga tregtia dhe turizmi

Mali i Zi ka modelin më të orientuar drejt shërbimeve të tregtisë, transportit, akomodimit dhe ushqimit. Së bashku, këto aktivitete zënë rreth një të tretën e vlerës së shtuar bruto, peshë më e lartë në rajon. Kjo strukturë pasqyron varësinë e madhe të ekonomisë malazeze nga turizmi. Në vitet me flukse të larta turistike, sektori sjell të ardhura, punësim dhe valutë, por një varësi e tillë e ekspozon vendin ndaj goditjeve të jashtme. Mali i Zi ka peshën më të ulët industriale në rajon, rreth 10-11 për qind, ndërsa financat dhe pasuritë e paluajtshme kanë një rol relativisht të rëndësishëm.

Maqedonia e Veriut, strukturë më e balancuar

Maqedonia e Veriut paraqet një strukturë relativisht më të shpërndarë ndërmjet industrisë, tregtisë, ndërtimit dhe shërbimeve. Industria zë rreth 21 për qind të ekonomisë, ndërsa tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi kanë një peshë të ngjashme. Ndërtimi përbën 7.2 për qind të vlerës së shtuar bruto, më shumë se mesatarja e BE-së, por më pak se në Shqipëri dhe Kosovë.

Bosnjë e Hercegovina ruan bazën industriale

Bosnjë e Hercegovina ka një nga peshat më të larta të industrisë në ekonominë e rajonit, me rreth 21 për qind të vlerës së shtuar bruto. Vendi mbështetet në industrinë përpunuese, energjinë dhe aktivitetet që lidhen me eksportet drejt tregut evropian. Ndërtimi ka një peshë shumë më të ulët se në Shqipëri dhe Kosovë, ndërsa tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi mbeten aktivitete të rëndësishme. Në tërësi, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të karakterizohen nga modele të ndryshme zhvillimi: Shqipëria nga ndërtimi, bujqësia dhe turizmi; Kosova nga industria, tregtia dhe ndërtimi; Serbia nga teknologjia dhe industria; Mali i Zi nga turizmi; ndërsa Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovina nga një bazë më e fortë industriale.

EDHE NËSE ARRIHET MARRËVESHJA, HORMUZI NUK DO TË HAPET MENJËHERË: JA PSE



Irani njoftoi se marrëveshja me Omanin për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit është pranë finalizimit, pasi të dyja vendet kanë rënë dakord për koordinatat e një korridorit të ri detar për anijet tregtare.

Ngushtica e Hormuzit lidh Gjirin Persik me Gjirin e Omanit dhe është një nga rrugët detare më të rëndësishme në botë, pasi në kohë normale përmes saj transportohet rreth 20% e naftës dhe gazit natyror të lëngshëm (LNG) në nivel global.

Irani e mbylli ngushticën pasi SHBA-të dhe Izraeli nisën sulmet ndaj territorit iranian në fund të muajit shkurt. Mbyllja e saj shkaktoi rritje të fortë të çmimeve të naftës dhe tronditi tregjet botërore të energjisë.

Prej javësh, Teherani dhe Muskati kanë zhvilluar negociatat për të gjetur një zgjidhje që do të lejonte rikthimin e lundrimit në këtë rrugë strategjike. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Esmail Baghaei, tha se bisedimet po ecin përpara dhe se palët janë në fazën përfundimtare të har-

timit të një deklarate të përbashkët.

Sipas tij, marrëveshja përfshin aspektet teknike, ligjore, të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit për korridorin e ri detar. Ai shtoi se procesi mund të përfundojë shpejt, nëse nuk pengohet nga faktorë të jashtëm, duke aluduar për veprimet e SHBA-ve.

Megjithatë, Baghaei theksoi se nënshkrimi i marrëveshjes nuk do të thotë automatikisht se Ngushtica e Hormuzit do të rihapet menjëherë. Sipas tij, Irani vazhdon ta konsiderojë praninë ushtarake amerikane dhe bllokadën ndaj porteve iraniane si pengesat kryesore për rikthimin e lundrimit normal.

Ai theksoi gjithashtu se marrëveshja është vetëm mes Iranit dhe Omanit dhe nuk përfshin negociatat të drejtpërdrejta me SHBA-të.

Edhe nëse arrihet një marrëveshje për Hormuzin, kjo nuk do të thotë fundi i krizës mes Iranit dhe SHBA-ve. Analistët vlerësojnë se ajo mund të krijojë kushtet për

rifillimin e bisedimeve më të gjera, por mbeten ende shumë çështje të pazgjidhura.

Çfarë kërkon Irani?

Teherani këmbëngul që Irani dhe Omani ta menaxhojnë së bashku Ngushticën e Hormuzit, sipas ujërave territoriale të secilit shtet. Autoritetet iraniane kanë bërë të ditur se rrugët e reja të lundrimit do të kalojnë kryesisht në ujërat territoriale të Iranit dhe pjesërisht në ato të Omanit, ndërsa korridoret aktuale do të mbyllen. Zëvendësministri iranian i Jashtëm, Kazem Gharibabadi, tha se korridoret e reja mund të përdoren për një periudhë prej dy deri në katër muaj, ose edhe më gjatë.

Irani ka lënë të kuptohet gjithashtu se synon të vendosë tarifa për disa shërbime detare, si asistencë në lundrim, pilotimi dhe mbrojtja e mjedisit. Megjithatë, sipas ligjit ndërkombëtar, nuk mund të vendosen tarifa vetëm për kalimin në një ngushticë

ndërkombëtare.

Po ashtu, Teherani ka deklaruar se nuk do ta rihapë plotësisht Hormuzin derisa SHBA-të të heqin bllokadën detare ndaj porteve iraniane.

Po Washingtoni çfarë kërkon?

Administrata e presidentit Donald Trump kërkon që anijet tregtare të lëvizin lirshëm në Ngushticën e Hormuzit, pa pasur nevojë për miratim nga Irani dhe pa paguar tarifa. Trump ka kundërshtuar publikisht çdo mundësi që Irani të përfitojë financiarisht nga kalimi i anijeve.

“Nuk do t’i lejoj të vendosin tarifa. Nëse dikush do të tarifojë, do ta bëjmë ne”, deklaroi ai.


Edhe 8 prej shoqatave më të mëdha të transportit detar në botë i kanë kërkuar OKB-së të kundërshtojë çdo tarifë për kalimin në Ngushticën e Hormuzit, duke argumentuar se kjo do të shkelte të drejtën ndërkombëtare dhe do të dëmtonte ekonominë globale.

Roli i Omanit

Omani vazhdon të luajë rolin e ndërmjetësit mes Iranit dhe SHBA-ve. Sipas analistëve, Muskati gëzon besimin e të dyja palëve dhe po përpiqet të rikthejë stabilitetin në rajon.

Ekspertët vlerësojnë se marrëveshja që po diskutohet është një kompromis. Irani ka hequr dorë nga kërkesa fillestare për kontroll të plotë mbi lundrimin, ndërsa SHBA-të pritet të pranojnë që Teherani të ketë një rol të kufizuar në administrimin e korridoreve detare.

Megjithatë, analistët besojnë se edhe nëse arrihet marrëveshja, statusi i Ngushticës së Hormuzit nuk do të kthehet më në gjendjen që ishte para nisjes së konfliktit mes SHBA-ve, Izraelit dhe Iranit. Sipas tyre, Teherani e ka kuptuar tashmë se kontrolli mbi këtë rrugë strategjike i jep një ndikim të madh në ekonominë botërore dhe nuk pritet të heqë dorë lehtë nga ky avantazh.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

AGIM ADEMI TAKOHET ME LEGJENDAT E LLAPIT: FUTBOLLI NA BASHKON EDHE PËRMES BREZAVE

PODUJEVË, 6 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka marrë pjesë në një aktivitet sportiv në Podujevë, ku është takuar me futbollistët legjendarë të Llapit nga diaspora dhe ata që jetojnë në Kosovë. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Ademi ka vlerësuar rëndësinë e ndeshjes reviale, e cila organizohet çdo vit që nga viti 2017, në periudhën kur mërgata kosovare rikthehet në vendlindje për të vizituar familjet e tyre. "Ishte kënaqësi të jem në Llap, në një ndeshje që organizohet çdo vit dhe që daton që nga viti 2017. Ajo zhvillohet pikërisht në këtë periudhë, kur mërgata jonë kthehet në vendlindje për të vizituar familjet e tyre", ka shkruar Ademi. Ai ka theksuar se ish-futbollistët nuk e harrojnë klubin e zemrës, Llapin, ku kanë dhënë

kontribut të madh, ndërsa ka vlerësuar traditën e kësaj treve në nxjerrjen e talentëve të futbollit. Ademi ka përmendur takimet me disa nga legjendat e klubit llapjan, përfshirë Idriz Mehmetin – Bellin, Esat Mehmetin dhe Rifat Hajdarin, kapitenin e Llapit të asaj kohe, si dhe futbollistët të tjerë të asaj gjenerate. Sipas tij, ndeshja reviale ka qenë më shumë se një përballje sportive, duke shërbyer si mundësi për bashkim, kujtime dhe rikthim të momenteve nga vitet e para të karrierës së tyre. "E këtë mund ta bëjë vetëm futbolla, prandaj jo rastësisht është slogani 'Futbolli na bashkon', ndërsa ne në Kosovë theksojmë moton 'Bashkë për futbollin', sepse së bashku e kemi ngritur futbollin dhe së bashku vazhdojmë ta çojmë edhe më lart", ka shkruar presidenti i FFK-së.




Ademi ka vlerësuar edhe kontributin e mërgatës në zhvillimin e futbollit, duke theksuar se shumë prej ish-futbollistëve që jetojnë jashtë Kosovës sot kanë fëmijët e tyre pjesë të ekipeve

zinxhir të Kombëtares së Kosovës. Ai ka falënderuar legjendat e Llapit për mikpritjen dhe respektin e treguar, duke theksuar se dyert e Federatës së Futbollit të Kosovës janë gjith-

monë të hapura për ta. "Duhet ta dinë se gjithmonë dyert e Federatës së Futbollit të Kosovës janë të hapura për secilin, sepse ajo është shtëpia e tyre", ka deklaruar Ademi.

ZHEGROVA: DUA TË SHKRUAJ HISTORI ME JUVENTUSIN



TORINO, 6 GUSHT - Edon Zhegrova është bërë protagonist në miqësoren e Juventusit ndaj Chelseat, ku ka shënuar golin që ia ka dhënë fitoren skuadrës bardhezi.

Pas paraqitjes pozitive, ylli i Kosovës ka folur për formën e tij, objektivat e sezonit të ri dhe dëshirën për të vazhduar aventurën në Torino, duke theksuar se synon të lërë gjurmë

me klubin italian. "Jam shumë i lumtur për golin dhe për mënyrën se si luajti ekipi. Gjithmonë ka vend për përmirësim dhe unë punoj çdo ditë që të bëhem më i mirë", ka deklaruar Zhegrova pas ndeshjes. Futbollisti i Juventusit ka thënë se shpreson që sezoni i ri të jetë më i suksesshëm për klubin dhe tifozët bardhezinj. "Shpresoj që sezoni i ri të jetë më

i mirë. Tifozët tanë meritojnë të festojnë dhe ne do të bëjmë gjithçka për të fituar", ka deklaruar ai.

Zhegrova ka pranuar se periudha e kaluar nuk ka qenë e lehtë për të për shkak të problemeve fizike, por ka theksuar se besimi në aftësitë e tij e ka ndihmuar të rikthehet më i fortë. "Sezonin e kaluar pata vështirësi, por gjithmonë kam besuar te vetja.

Jam i lumtur me veten dhe me Juventusin", ka thënë 26-vjeçari. Duke folur për të ardhmen, Zhegrova ka bërë të qartë se dëshiron të vazhdojë me fanellën e Juventusit dhe të kontribuojë në sukseset e klubit. "Juventusi është një klub i madh. Dua të qëndroj këtu dhe të vazhdojmë të bëjmë gjëra të mëdha së bashku", ka përfunduar ai.

INFANTINO MBETET NË KRYE TË FIFA-s, KËRKON FALJE PËR "GABIMET" NË PLANIN PËR INVESTIME PRIVATE

ZURICH, 6 GUSHT - Gianni Infantino do të vazhdojë të jetë president i FIFA-s, pasi ka marrë mbështetjen e drejtuesve të lartë të organizatës, pavarësisht kritikave të shumta ndaj planit të tij për shitjen e aksioneve të garave te investitorët privatë.

Infantino ka kërkuar falje për "gabimet" e bëra në këtë proces, gjatë një takimi të bordit drejtues të FIFA-s në zyrën e organizatës për Afrikë në Rabat të Marokut. Katër orë pas përfundimit të takimit, FIFA ka publikuar një deklaratë ku konfirmoi mbështetjen për kreun e saj. Kritikant ndaj Infantinos ishin rritur pas

anulimit të propozimit për investime private në turnetë e FIFA-s. UEFA kishte deklaruar se kishte humbur besimin te presidenti i FIFA-s, duke e cilësuar propozimin si një "mar-rëveshje të mjerë, të fshehtë dhe të errët". Kundërshtime ndaj këtij plani pati edhe brenda FIFA-s, përfshirë sekretarin e përgjithshëm Mattias Grafstrom, i cili mori pjesë në takimin në Marok. Megjithatë, pas mbledhjes, Grafstrom dhe bordi drejtues "riafirmuan mbështetjen e tyre të plotë" për Infantinon si president. Infantino dhe Grafstrom u kanë dërguar një letër nënkryetarëve të FIFA-s,



këshillit dhe 211 federatave anëtare, ku kanë kërkuar falje për gabimet dhe janë zotuar që ato të mos përsëriten. "Ne kërkojmë ndjesë sinjerisht për gabimet tona dhe angazhohemi që ato të mos ndodhin

përsëri", është thënë në letrën e tyre.

Sipas raportimeve, Infantino u kishte premtuar federatave kombëtare nga 40 milionë dollarë nëse do të mbështesnin propozimin për investime private në garat e FIFA-s, përfshirë Kupën e Botës. Ky plan do të realizohej përmes një strukture të re të quajtur FFE. FIFA ka pranuar se janë bërë gabime në lidhje me këtë proces, duke theksuar se federatat anëtare dhe Këshilli i FIFA-s nuk është dashur të ndiheshin të përgjash-tuara nga vendimmarrja. Pavarësisht kësaj, FIFA ka deklaruar se procesi është zhvilluar në përputhje me

kuadrin rregullator të organizatës dhe ka paralajmëruar se do të mbrojë integritetin dhe reputacionin e saj. Kritikant ndaj Infantinos kanë vazhduar edhe pas mbështetjes së marrë nga drejtuesit e FIFA-s. Kryeministri i Kanadasë, Mark Carney, ka deklaruar se nuk ka më besim te ai, ndërsa ish-futbollisti portugez Luis Figo i ka bërë thirrje për dorëheqje. Megjithatë, Infantino pritet të kandidojë për një mandat të katërt në krye të FIFA-s. Zgjedhjet do të mbahen në mars në Marok, ndërsa kandidatët potencialë kanë afat deri më 18 nëntor për të paraqitur kandidaturat.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1253/1
Dt: 06.08.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr: 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsimit dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Mësimdhënës/e i/e lëndëve të Makinerisë, profili INKU	Vend i lirë	2	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Mësimdhënës/e i/e lëndëve të Elektroteknikës	Vend i lirë	1	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Mësimdhënës/e i/e lëndëve të Elektroteknikës (mësim në gjuhën turke)	Vend i lirë	1	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike.	Vend i lirë	2	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Angleze.	Vend i lirë	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjisllacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT;
- Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.

- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrativ përkatës të **MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e i/e lëndëve të Makinerisë, profili INKU

- MSc. i makinerisë
- Inxh. i dipl. i makinerisë

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e i/e lëndëve të Elektroteknikës

- MSc. i elektroteknikës - elektronikës
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës – elektronikës

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës fizike

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës angleze

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga dt. 07.08.2026 deri me dt. 05.09.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1254/1
Dt: 06.08.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Instruktor për module të praktikës profesionale për profilin Dizajn Softver	Zëvendësim	1	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Instruktor për module të praktikës profesionale për lëndën e TIK-ut	Zëvendësim	1	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Instruktor për module të praktikës profesionale për lëndën e TIK-ut (Mësim në gjuhën Boshnjake)	Zëvendësim	1	6.8
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Instruktor për module të praktikës profesionale për profilin Dizajn i metaleve	Vend i lirë	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike).

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Çertifikatat e trajnimeve;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera (dëshmi të përvojës së punës: vërtetim ose kontratat e punës);
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, UA Nr. 05/2021, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024, si dhe procedurave të përcaktuara me komizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për instruktor për module të praktikës profesionale për profilin Dizajn Softver

- Bachelor- Shkenca Kompjuterike
- Bachelor - Elektroteknikë - elektronikë

Kriteret e kualifikimit për Instruktor për module të praktikës profesionale për lëndën e TIK-ut

- Bachelor- Shkenca Kompjuterike / Teknologji Informative

Kriteret e kualifikimit për instruktor për module të praktikës profesionale për profilin Dizajn i metaleve

- Bachelor- Makineri

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitë e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 07.08.2026 deri me 05.09.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitë e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1255/1
Dt: 06.08.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës-drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShMP	Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”	Malishevë	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë gjermane	Zëvendësim	1	6.8

- I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune**
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
 - Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
 - Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:**
- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
 - Rezymeja personale (CV);
 - Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
 - Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
 - Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**;
 - Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHTI;
 - Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
 - Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
 - Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjithësisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
 - Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
 - Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrativ përkatës të **MASHTI-it: Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë gjermane

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitë të lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 07.08.2026 deri me 05.09.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitë të shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1256/1
Dt: 06.08.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësrektorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës në Skenderaj	Skenderaj	Mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës	Zëvendësim	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar në MASHTI;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHTI;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrativ përkatës të MASHTI-it: Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2021 si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Matematikë

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitën e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data e shpalljes nga data 07.08.2026 deri me 05.09.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitën e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



CONTRACT AWARD NOTICE
SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 06/08/2026

Procurement No	Training	002	2026	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English ☒

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name:Kosovo Humanitarian Charitable Society “Mother Teresa”		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code:10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone:044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Profesional training for 300 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

	☒ Services
	Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Profesional training for 300 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots NO ☒

II.1.7) Contract value: 29,700.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

☐ Open

III.2) AWARD CRITERIA

☐Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat SIV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 06/08/2026	
IV.2) Intended date of contract signing 14/08/2025	
IV.3) Number of received tenders 3	
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded	
Official name: “D&D” Business Support Centre “L.L.C. Pristine	
Postal address: 10000 Pristine	
Town: Pristine	Postal code:10000
Country: Kosovo	
URL (if applicable):	
Contact point(s): Safet Fazliu	Email: info@dd-bsc.com
Telephone:	Fax:

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 29,700.00 Euro

Responsive tender with lowest price: 29,700.00 Euro

Responsive tender with highest price: 30,600.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted No ☐

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.

NJOFTIM

Njoftojmë se kompania “Eren Tekstil SHPK” nga Prishtina, me numër unik identifikues 812328781 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit. Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the company “Eren Tekstil SHPK” with address in Prishtina, has decided to close the business with unique identification number 812328781, and has appointed the liquidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klijentelu da je kompanija “Eren Tekstil SHPK”, sa adresom Prishtina, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 812328781, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908